

**Gjergj
Zheji**

BIBLIOTEKA
SHETIT

KULLAT

Roman

8SH-31

2243

GJERGJ ZHEJI

KULLAT

Roman

(Botim i dytë)



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

GJERGJ SHKURT

KULLAT

ROMAN

(ROMAN I DËGJË)



Tirazhi 10.000 kopje

Format 78x100/32

Stash: 2204-72

KOMBINATI POLIGRAFIK — Shtypshkronja e Re
Tiranë, 1976

VALLE VETËTIMASH

Nëpër frengji llapsin vetëtimat. T'i verbojnë sytë. Duket sikur mbi kulla, në mes të errësirës, përplasen hera-herës rreze të bardha projektorësh të mëdhenj.

Kullat, me mure të nxira e me myshk të kalbur gjëmojnë sikur të ishin guva të lagështitura. Rrapëllima të shurdhon... Sa herë që shkrep një rrufe, të ngjan se ka shkarkuar diku mbi rrasat e pullazeve të lëmuara nga reshjet e moteve... Mbi lëmin e shkretë, ndanë pusit me ujë të ftohtë, pikat e shiut bien të mëdha, si mana të butë.

Stuhi vere në Gruz...

Trokëllinjë gjethet, drurët, plloçat...

Të bëhet se lart, të xhadeja që gjarpëron buzë humnerash për në Qafë, kanë ndalur kamiona që kanë ulur spondet e po derdhin shpatit të rrëpirë qindra metra kub zhavorr... Guraçokët rrokullisen me potere, të shtyrë nga era; fluturojnë nëpër ara, avlli, kulla e gjerdhe deri sa bien poshtë, në shtratin e shtrembër të lumit...

Në kupën e zezë të qiellit të përflakur, copërat e reve varren si plumb i avulluar. Shtëllungat vigane ngajjnë si përbindsha të dehur, që rrokullisen dhe përpjekin maleve trupat e tyre të zdërlaqur.

Larg, mbi mjegullinën e shiut të rrëmbyer, kreshtat e maleve përcëllojnë duart duke rrokur vetëtimat e zjarrta. I shkoqin me gishtërinjtë e tyre të mermertë, e atëherë, mbi kullat

e vetmuara rrufetë roniten si fushqeta me shkëndija të prushta...

Ky është Gruzi me kullat e shpërndara larg njëra-tjetrës, pranë ngastrave të arave si arna të zhërdhylura në një rrobe të çjerrë. Nga malet rrjedhin rrëke me ujëra të fryra e të rrëmbyera. Një përrua argjiloz prapa fshatit skuq kur e kur, në shkëlqimin e vetëtimit, nga plagët e vithisjeve të fundit. Pylli i Llakufit gumëzhin mbi rrashtën e zezë të një kodre. Këtu toka e bukës është e paktë. Gurët — det. Si në Zagorinë time. Megjithatë gruzakët nuk ikën që këtu, nuk i braktisën kurrë këto rripa, bokërina dhe ara të mbjella me gurë, të varura si për çudi në vetulla humnerash të kaltra. Në Zagori ndesh mushkat me tringëllimat e zileve në qafë e ato të kujtojnë kurbetin; kurse këtu, kullat. Me gurët e rëndë e me vetminë e lashtë, ato ta thonë shkoqur se banorët e tyre nuk e kanë njohur kurrë rrugën e përlotur të mërgimit. Kanë luftuar, kanë vuajtur për bukën e gojës, i kanë ngritur pusi njëri-tjetrit, u janë ashpërsuar duart e fytyra, janë bërë të vrazhdë në të folur dhe të egër në zakone, po kurrë nuk i kanë lënë të shkreta kullat dhe skërkat e bardha.

Kjo është e mira e tyre.

Kjo është fatkeqësia e tyre.

Me kohë gruzakët u mësuan të ruhen nga çdo gjë që vinte tej Gruzit. Gruzi vetë u bë për ta si një kullë e madhe, me sharapolla hijerëndë e frengji hakmarrëse në të katër anët e horizontit të pabesë...

Po ata vetë, gruzakët, a nuk ishin vallë kulla të gjalla, që roniteshin në vetminë e tyre kryelartë e të vobektë?

Vetmia është shpirti i kullave.

Megjithatë, kur i sheh që ngrenë kryet majë brigjesh, mbi pyjet e dendura a në sjetull të malit, është e pamundur të mos besosh se edhe kullave u është rënduar vetmia... Të ngulura në një vend janë, por i merr malli kur e kur ta thyejnë vetminë monotone që t'i lodh mendimet. Atëherë mundohen të shkëmbejnë ndonjë fjalë me kë munden. Në errësirën e natës, shi qoftë a hënë me yje, ato bisedojnë me njëra-tjetrën. Kur nuk i dëgjon kush dhe zëri i tyre tretet në heshtjen e maleve, atëherë nisin të murmurisin me vete, shohin ç'bëhet në kthinat e tyre dhe murmurisin...

Në fund të shpatit, në një shtrat të çrregullt, që diku zgjerohet si një dorë me gishtërinj viganë, diku ngushtohet si një karthijë e shtrembër nyje-nyje, rrjedh Lumi i Zezës. Po kullat nuk kanë punë me lumin. Lumi është për gratë. Ato i lajnë lëveret. Lajné lëveret dhe u fryjnë duarve të skuqura që u ngrijnë nga uji i akullt. Kullat mbeten atje ku janë, si burrat, pushkët e fisit. Është e vërtetë se, sa më shumë kohë kalon, aq më tepër u zbutet zemra kullave, se mosha u thyen durimin, u ronit shpirtin si një brengë e thellë që shërohet vetëm me të butë e me një fjalë të mirë. Bëj hesap, ato sot kanë nisur të ngashërehen edhe nga fjalët e grarisë... Por kulla është kurdoherë kullë, ajo është e lidhur me pushkët e shtëpisë. Dhe aq shumë mësohet me burrat e fisit, sa që bëhet dhe ajo si ata, vrenjtet si ata, e trash zërin dhe flet me rëndësi si ata... Edhe kur lufton, lufton si ata... Ka kulla që janë trime, si të zotët, dhe u dalin hasmëve ballas; ka të tjera që edhe në të parë duken tinzare, me frengji si sy të fjetur, po që në të vërtetë vetëm bëjnë sikur kanë fjetur, se befas hapen dhe flaka e pushkës çel në errësirë si një trëndafil kërmes. Ka kulla që duken sikur luftojnë në heshtje, pa bujë që, edhe kur e mposhtin armikun, nuk thërrasin, por kthejnë sytë mënjanë, sikur mendohen; ka kulla që përleshën duke klithur dhe në mes të zjarrit të pushkëve nisin të qeshin me të madhe... Era e barutit u gudulis hundët, krismat e thata të armëve i bëjnë të çmenden nga gëzimi...

Gjethurinat e lagura shkëlqejnë nga llamburitja e vetëtimeve që çajnë errësirën dhe e ndajnë copë-copë...

Mua më bëhet se jashtë kullat vazhdojnë bisedën e tyre... Mjafton t'u dish gjuhën, për t'u njohur gjer në fund zemrën. Me poteren e shiut, të erës, të bubullimave, përzihen dhe zërat e tyre, që gjëmojnë në shpatin e mbuluar nga copërat e çjerra të reve. Me ata zëra që përleshën me erën, me ato fjalë që lagen nga shiu, fluturojnë histori të thinjura, legjenda të ashpra, rapsodi të forta, por edhe këngë kumbuese për njerëz të rinj.

NDRYSHKU I BURRAVE

Jashtë bie shi me gurgullime të potershme. Vështroj trarët e qeptrat e çatisë, që humbasin në errësi-
sirë.

Nuk më zë gjumi.

Nga ana tjetër e vatrës gërhet i zoti i shtëpisë. Afër derës plaka e hollë dhe e imtë flet nëpër gjumë. Dy shoqet e mia kanë shtruar pranë tri frengjive të sharapollit. Thoshin se u zihej fryma; frengjitë e ngushta nuk e ajrosin dot atë kthinë, që qëndron në terr ditë e natë. Diku dëgjohet turfullima e dhive. Malet gjëmojnë nga bubullimat. Shiu përplas-
set dallgë-dallgë mbi fletët e misrit ndanë kullës...

U bë një javë që kemi dalë nga Kruja. Jemi plot katërbëdhjetë arsimtarë. Një brigadë e tërë kulturore. I kemi zënë me radhë këto fshatra malore. Në Gruz kemi arritur në mëngjes herët. Zbritëm nga Qafa e Shtamës, lamë Bruzin pas, u varëm poshtë nëpër Qafën e Larit, qafë e lodhshme, tërë shtuf e argjil, u çlodhëm e u freskuam në kroin e parë që ndeshëm e pastaj u bashkuam në punë me fshatarët.

Kooperativa e tyre është e re, s'ka ca muaj që mbushi vitin. Nuk janë ndarë keq me ditët e punës, dhe kjo i ka bërë t'u shtohet besimi.

Atë dimër, kur dhanë fjalën për t'u bashkuar, shumë hy-në si me zemër të thyer në kooperativë, me qindra dyshime e lëkundje. Edhe pasi ishin bërë kooperativistë, ende e ndienin veten si në hava, sikur gjendja e tyre ishte diçka e përkohshme

dhe një mëngjes do të zgjoheshin nga kjo trulllosje, ku i kishte kredhur malli për atë çikë gjë që kishin vënë në ekonominë e përbashkët... Tani qeshin e tallen me kokëfortësinë e tyre të atëhershme.

— E shikoni këtë?, — thotë kryetari i kooperativës duke treguar një malësor që i ka kaluar të pesëdhjetat, një burrë me ca faqe labucere e me ca qepalla të zbërdhlyëta... — Lik Pacaneshi i thonë... Dy muaj rresht e mbajti ekipin e meazalla se dëgjonte...

Lik Pacaneshi heq llullën me dru bushi nga goja dhe, duke e rrahur në pëllëmbën e rreshkur, kollitet e qesh. Fytyra e tij bëhet gjysmë babaxhane, gjysmë dinake.

— Mos na cyt, or Selim..., — thotë për t'u tallavitur, por duket që ka qejf ta cysin.

— *Përse nuk do, or Lik Pacaneshi?*, — e pyesnin shokët.

— *Or lum miku*, — thoshte Liku, — *jemi vend i thyer ne, vend i egër... Lepuri i egër s'bëhet i butë!*

— *Po lepujt e butë*, — ia priste tjetri, — *a s'kanë qenë të gjithë të egër më parë?*

— *Atë s'e di!* ia kthente Liku dhe u binte me mashë urëve në vatër.

— *Or Lik Pacaneshi*, — i thoshin, — *shih shokët. Na thuaj një fjalë tjetër. Njëqind herë në një vrimë nuk i bihet kavallit. Gishtat luajnë!*

— *Gishtat e mi janë ftohur!*

Lik Pacaneshi dëgjon përgjigjet që jepte në atë kohë dhe qesh duke e hedhur qelshen mbi sy...

— Kurse ky tjetri, — vazhdon kryetari i kooperativës, — e hiqte veten plak! Megjithatë, fëmijën e fundit s'e ka as gjashtë vjeç... Apo jo, Dyl Shkarreli?

Të gjithë qeshin. Dyl Shkarreli kruan kokën si me shejtanllëk.

— Ato janë punët e zotit..., — thotë dhe kafshon mustaqen.

— Punët e zotit që i di i zoti..., — ia pret Liku duke pulitur njërin sy me dinakëri.

— Plak i fortë je, Dyl, — ia pat një tjetër, — me flokë të thinjur si pendët e korbrit!

— Kjo është dasmë e madhe, or Dyl Shkarreli, i thanë,
e duam të vish edhe ti!

— Pleqtë, — tha Dyli, — nuk janë për dasmë...

— Mos e thuaj atë fjalë, or burrë...

— Unë jam i vjetër, nuk jam më për punë... Pyesni gruan... Oj grua, — i foli zojnores, — si thua ti? A ke takat të punosh? Fol këtu, që pastaj të mos na dalë fjalë as me qeverinë, as me katundin! — Zojnorja vuri dorën në gojë, sikur kishte frikë se mos gjuha lëvizte pa lejen e saj. — Sa për vete, — vazhdoi Dyli, — unë do ta kërkoj me shkrim prej kooperativës, në qoftë se do të hyj, që të m'i sigurojnë të gjitha e unë të mos kem nevojë të ngrihem e të largohem nga carani i vatrës!

— Heu! — ia bënë shokët e ekipit.

— Po pse, ç'ke ti kështu?

— Dhe Dyl Shkarreli:

— Pleqni! Pleqni!

Dyli s'i kishte mbushur të pesëdhjetat. Kishte një fytyrë grumbullore, një kokë të rumbullakët me një zverk të shëndoshë e tërë muskuj, që i fryshin sikur do të pëlcnin sa herë ia shkrepse gazit. Flokët ia kishte përcëlluar dielli, mjekrën e kishte të kuqërreme e të dendur si një copë shajaku të trashë. Tani e kishin caktuar brigadier dhe ai e kishte harruar «pleqërinë»...

Kryetari i kooperativës nuk ishte vendës, kishte ardhur nga një kooperativë e fushës, ku kishte qënë një nga brigadierët më të dalluar. Do të qëndronte dy vjet në Gruz, sa kooperativa e re të mëkëmbej në një farë mënyre. Ishte i ri, as tri-dhjetëvjeç djalë, dhe përherë i qeshur. Flladi i lehtë që frynte nga lumi ia ndukte flokët kaçurrela. Në fillim e kishte pasur të vështirë edhe për punë të moshës.

— Kur erdhi për herë të parë Selimi — nisi të tregonte Lik Pacaneshi — s'na e mbushi syrin fare... Na mblodhi e na foli: «Ju, o burra, thoni se katundi është gur e zhur, s'ka tokë buke... kurse unë ju them se, këtu ku jemi, ka tokë sa të duash... Mjafton të lodhesh pak...» Ne pamë në sy sho-shoqin e na dukeshin fjalët e tij si punë axhamiu... Por, kur përveshëm mëngët, dogjëm ferrat, shkulëm kaçubet, çamë shkëmbinjtë, mbe-tëm gojëhapur... Heu, thamë, sa tokë e fshehur paska qenë, or

burra!... Bëj hesap: këtë vit për herë të parë ne do të bëjmë bukën e vitit... Bukën e gjithë vitit katundi ynë, më keq se Bruzi, gur e zhur, që për vite me radhë ka vuajtur për kazan e rraqe!

Vështroj trarët e qeprat e zeza të pullazit të kullës dhe më bëhet se ata janë nxirë jo nga bloza e tymi, por nga vuajtjet. Edhe ata kanë dëgjuar për kaq vite e vite me radhë pshe-rëtimën e madhe e të uritur për kazan e rraqe, për bukë e veshmbathje ... Ka të drejtë Lik Pacaneshi me shokë që thonë se vetëm tani, pas njëzet e ca vjet çlirim të atdheut, ata po shijojnë lirinë...

Vitin që vjen, nga këta trarë të nxirë do të varet llampa elektrike. Ajo llampë do të ndriçojë e fortë jo vetëm këtë kthinë, por edhe thellë zemrën e mendjen e Xhixhë Brokës e të njerëzve të tij... Do t'u lbyren sytë të gjithëve. Lopët e dhitë në qilar do të ngrenë kokën lart të shohin nëpër të çarat e tavanit rrezet e diellit të çuditshëm, që është futur në kthinat e të zotërve... Ndërsa të zotët do të shohin poçin elektrik e do të mendojnë se kulla duhet shembur... Lampa elektrike nuk e ka vendin në ata trarë të nxirë. Do të shemben kullat dhe Gruzi, Rranxa, Bruzi, Cudhini e fshatra të tjera do të rilindin... Jo më fshatra me kulla që dridhen në vetminë e tyre lakuriqe, por katunde me shtëpi të bashkuara, me një shesh, klub, shkollë dhe dyqane pranë e pranë... Atëhere gruzakët do ti harrojnë legjendat e hakmarrjes e do t'i kalojnë mbrëmjet duke dëgjuar në radio muzikën e kërkuar apo teatrin në mikrofon... Atëherë Xhixhë Broka do t'i presë miqtë në dhoma të ndritura, me dritare të mëdha e perde, do t'u shtrojë të hanë në tryezë, do t'u verë përpara pjata, thikë, lugë e pirunë e, duke ngrënë, për të mbajtur gjallë bisedën, do të thotë: «S'e kuptoj, xhanëm, përse autokinemaja shfaq filma kaq të vjetër në katundin tonë?».

— Erdhën shoqet, — tha Selimi. — Çohemi, burra?... Vendi s'të thotë kurrë «ngrehu!».

Brigada e grave erdhi me vegla në duar. Ishin me kostumet e bardha të vendit, plot qëndisma të holla në mëngë, grykëse dhe stërvec. Tek-tuk të zinte syri ndonjë të re që kishte veshur një palë tuta, mbi të cilat kishte hedhur futën. Vetëm